Albanians Without Borders
Phone: 646-235-2211
Email: info@albanianswithoutborders.com
Website: albanianswithoutborders.com

LETËR E HAPUR KRYEMINISTRIT EDI RAMA

17 nëntor 2026

Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë
z. Edi Rama

Ne, organizatat Shqiptaro-Amerikane të nënshkruara si më poshtë, mbështesim protestat paqësore, të drejtat kushtetuese të protestuesve dhe thirrjet e tyre për t'i dhënë fund korrupsionit, për më shumë transparencë e përgjegjshmëri politike dhe për reforma.

Për më shumë se katër muaj, Shqiptarët protestuan pa incidente madhore. Sikur t'u ishit përgjigjur kërkesave të tyre me dialog kuptimplotë, komuniteti ndërkombëtar do të kishte parë qytetarë që ushtrojnë të drejtat e tyre dhe një qeveri që u përgjigjet shqetësimeve të tyre. Në vend të kësaj, po dëshmojmë një krizë.

Që prej 13 tetorit 2026, tensionet janë përshkallëzuar në përplasje, plagosje dhe dëmtim të pronës. Qeveria duhet të tregoj përmbajtje për të ulur tensionet jo të përdorë forcën joproporcionale, të kryej arrestime masive dhe të ushtroj dhunë. Pas dhunës, qeveria vendosi gjoba të rënda dhe miratoi ligje kufizuese. Këto veprime kanë cenuar të drejtat civile, kanë thelluar mosbesimin dhe kanë nxitur më tej trazirat.

Qeveria ka detyrimin të garantojë sigurinë dhe rendin publik brenda kufijve të ligjit. Kushtetuta mbron lirinë e tubimit, të shprehjes dhe të shtypit, procesin e rregullt ligjor, prezumimin e pafajësisë dhe të drejtat e personave të ndaluar. Çdo kufizim duhet të jetë i parashikuar me ligj, proporcional dhe në përputhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në interes të paqes, drejtësisë dhe të ardhmes së Shqipërisë, ju bëjmë thirrje:

1. **Ndaloni përdorimin e dhunës.** Ndaloni përdorimin e plumbave prej gome, ujit me presion dhe gazit lotsjellës kundër protestuesve e gazetarëve. Ulni praninë e rëndë të forcave të rendit në protestat paqësore dhe mos përdorni gjoba apo ndalime udhëtimi pa vendim

gjyqësor për të ushtruar presion ndaj protestuesve. *(Nenet 17, 22, 25, 38, 42, 47)*

2. **Bëjeni policinë të identifikueshme.** Efektivët duhet të mbajnë shenja të qarta dhe dokument identifikimi gjatë shërbimit, sipas standardit që u kërkohet qytetarëve. *(Nenet 4, 15)*
3. **Ndaloni arrestimet arbitrare.** Lironi këdo që është ndaluar vetëm për pjesëmarrje në protesta paqësore. Çdo të ndaluari duhet t'i bëhen të ditura menjëherë arsyet e arrestimit, në një gjuhë që kupton, dhe t'i sigurohet qasje te avokati. Ofroni avokat falas atyre që nuk mund ta paguajnë. *(Nenet 27, 28, 31, 42)*
4. **Mbroni të miturit.** Hetoni në mënyrë të pavarur pretendimet për dhunë policore ndaj tyre. Mos merrni në pyetje asnjë fëmijë pa praninë e prindit ose kujdestarit, avokatit dhe psikologut, siç kërkojnë ligji shqiptar dhe standardet ndërkombëtare. *(Neni 54)*
5. **Pezulloni legjislacionin e ri për protestat.** I miratuar me dekret emergjence më 28 tetor 2026, pa debat parlamentar, legjislacioni vendos kufizime të gjera mbi tubimin, shprehjen dhe lëvizjen, si dhe gjoba të rënda. Mos e zbatoni derisa të shqyrtohet nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni i Venecias, e të debatohet në Parlament. *(Nenet 17, 22, 38, 47, 101)*
6. **Ndaloni ndëshkimin pa gjyq.** Mos i regjistroni qytetarët si "individë të dhunshëm" dhe mos ua kufizoni qasjen në transport, aeroporte apo hotele pa vendim dënimi nga gjykata. Respektoni për qytetarët të njëjtin prezumim pafajësie që qeveria juaj ka kërkuar për zyrtarët e saj. *(Nenet 18, 30, 35, 38, 42)*
7. **Bëjeni publik dokumentacionin.** Brenda 30 ditësh, publikoni një raport mbi reagimin e policisë që prej 13 tetorit 2026, në përputhje me udhëzuesin e OKB-së për armët me efekt joletal dhe udhëzimet e OSBE-së e Komisionit të Venecias për lirinë e tubimit paqësor. Raporti të përfshijë urdhrat për përdorimin e forcës, incidentet, armët e municionet, kontrollet, arrestimet, ndalimet, plagosjet dhe masat disiplinore. Ruani të gjitha dokumentet e provat, përfshirë pamjet filmike dhe komunikimet zyrtare, për shqyrtim të pavarur. *(Nenet 23, 35)*
8. **Lejoni mbikëqyrjen ndërkombëtare.** Jepuni hetuesve ndërkombëtarë qasje të plotë dhe qytetarëve një mënyrë të sigurt për të raportuar abuzimet. Dokumentoni e hetoni çdo ankesë në mënyrë të paanshme dhe mbani përgjegjës zyrtarët e komandantët që urdhëruan, nxitën ose toleruan shkeljet. *(Nenet 15, 122)*
9. **Dëmshpërbleni dhe kujdesuni për viktimat.** Dëmshpërbleni personat e prekur nga përdorimi i paligjshëm i forcës, ndalimi i paligjshëm ose

shkelje të tjera të të drejtave civile. Sigurojuni ndihmë juridike, mjekësore dhe psikologjike falas nga ofrues të pavarur. *(Nenet 44, 55)*

10. **Merrni përgjegjësi politike.** Jepni dorëheqjen për të rikthyer besimin e publikut dhe lehtësoni një tranzicion paqësor që krijon kushtet për reforma institucionale e zgjedhore, mbrojtje të të drejtave themelore dhe zgjedhje të lira e të ndershme.

Si aleat i NATO-s, vend kandidat për anëtarësim në BE dhe anëtar i OKB-së, Shqipëria është zotuar ndaj demokracisë, lirive individuale dhe shtetit të së drejtës. Presim që qeveria juaj të respektojë Kushtetutën dhe të bashkëpunojë plotësisht me SPAK-un, edhe kur hetimet përfshijnë anëtarë të saj.

U bëjmë thirrje Shteteve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe institucioneve ndërkombëtare të kryejn hetime të pavarura mbi shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe korrupsionin, si dhe të mbrojnë SPAK-un nga ndërhyrjet politike. I nxisim të përdorin mjetet diplomatike për të kërkuar llogaridhënie nga autoritetet Shqiptare. Bashkimit Evropian i kerkojme t'i ngrejë këto çështje edhe në bisedimet e negociatave për antarësimin e Shqipërisë. Ftojmë vëzhgues të të drejtave të njeriut, juristë dhe gazetarë të dokumentojnë zhvillimet në Shqipëri.

Nderojmë guximin e studentëve, arsimtarëve, gazetarëve dhe qytetarëve që kanë dalë në rrugë. Shqiptaro-Amerikanët qëndrojnë me ta dhe do të vazhdojnë t'i ngrenë zërat e tyre pranë qeverive e institucioneve ndërkombëtare derisa të drejtat e tyre të respektohen. I nxisim protestuesit të mbeten paqësorë, të palëkundur dhe vigjilentë.

Kjo krizë kërkon zgjidhje politike, dhe çdo zgjidhje politike kërkon sakrificë. Kjo sakrificë mund të vijë vetëm nga ata që udhëheqin.

Me respekt,

Organizatat nënshkruese, deri më 17 nëntor 2026:

AjkunBT
Albanian American Association Ana e Malit Inc
Albanian American Association Ulqini – Chicago
Albanian American Association, Inc.
Albanian American Bar Association of Illinois
Albanian American Cohesive Community
Albanian American Community Association of Long Island
Albanian American Council
Albanian American Cultural Foundation
Albanian American Dual Language & Culture Children of the Eagle
Albanian American Educators Association
Albanian American Humanitarian Foundation
Albanian American Humanitarian Fund Trojet Tona
Albanian American Muslim Community & Cultural Center
Albanian American Open Hand Association
Albanian American Organization Chameria
Albanian American Puka Community Association
Albanian Americans in Architecture, Construction & Engineering
Albanian Community Resource Center
Albanian Community TV Michigan
Albanian Cultural Association Shpresa
Albanian Culture TV
Albanian Women Foundation
Albanian Youth Center / Albanian Heritage
Bajraktari House
BashkeRi Initiative
Bashkimi Kombëtar
Bleta Foundation
Common Sense Club
Don Gjon Buzuku Association – Chicago
Don Gjon Buzuku Association – New York
Fondacioni Hoti i Kujit
Fondacioni Plavë Guci
Global Albanians Foundation
Grupi Rozafati
Illyrian Business Organization
Kosova Lindore Association

Malesia Association of California
New Life AACO
Nora e Kelmendit
Plava e Gucia Sot
Prek Cali Foundation of NY
Ringjalle Project
Shkodra Association Rozafa
Shoqata Atdhetare Kraja
Shoqata Autizmi
Shqipëria Tjetër
The Women's Organization Hope & Peace
USA Albanian Society NYC
Vermoshi Foundation
Westchester Albanian American Merchant Association

Kjo letër mbetet e hapur për nënshkrues të tjerë; një listë e përditësuar do t'u dërgohet të gjithë marrësve.

Deklaratë: Kjo letër është një deklaratë jopartiake në mbështetje të të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe qeverisjes demokratike në Shqipëri. Ajo nuk mbështet dhe nuk kundërshton asnjë parti politike apo kandidat për post publik. Thirrja e saj për dorëheqje bazohet në sjelljen e qeverisë dhe në detyrimet e saj sipas Kushtetutës. Letra nuk është kërkuar, drejtuar, kontrolluar apo financuar nga asnjë qeveri e huaj, parti politike apo subjekt tjetër i huaj, dhe asnjë fond bamirësie nuk është përdorur për përgatitjen apo shpërndarjen e saj. Çdo organizatë është e pavarur dhe nënshkruan në emër të vet.

CC (lista e marrësve, 246):

United States
– Brendan Hanrahan, Assistant Secretary, Bureau of European and Eurasian Affairs, U.S. Department of State
– Commission on Security and Cooperation in Europe (U.S. Helsinki Commission)
– Congressional Albanian Issues Caucus
– The Honorable Marco Rubio, Secretary of State
– National Security Council, The White House
– Representative Brian Mast, Chairman, House Foreign Affairs Committee
– Representative Chris Smith, Co-Chair, Tom Lantos Human Rights Commission
– Representative Gregory Meeks, Ranking Member, House Foreign Affairs Committee
– Representative Jim McGovern, Co-Chair, Tom Lantos Human Rights Commission
– Riley M. Barnes, Assistant Secretary, Bureau of Democracy, Human Rights, and Labor, U.S. Department of State
– Senator Jeanne Shaheen, Ranking Member, Senate Foreign Relations Committee
– Senator Jim Risch, Chairman, Senate Foreign Relations Committee
– Subcommittee on Europe, House Foreign Affairs Committee
– Subcommittee on Europe, Senate Foreign Relations Committee
– U.S. Embassy in Tirana, Ambassador Eric Wendt
– U.S. Mission to the Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE)
– U.S. Mission to the United Nations

European Union
– Ambassador Sofia Moreira de Sousa, Head of the EU Delegation to Albania
– Andreas Schieder (MEP), European Parliament Standing Rapporteur on Albania
– António Costa, President of the European Council
– Arba Kokalari, Member of the European Parliament (MEP)

– Chiara Gemma, Member of the European Parliament (MEP), Vice-Chair, EU–Albania Stabilisation and Association Parliamentary Committee
– Council of the European Union Presidency
– David McAllister (MEP), Chair, Committee on Foreign Affairs, European Parliament
– Directorate-General for Enlargement and Eastern Neighbourhood, European Commission
– EU Coordinator for the Rights of the Child, European Commission
– EU Special Representative for Human Rights
– European Parliament Intergroup on Children's Rights
– European Union Agency for Fundamental Rights (FRA)
– Kaja Kallas, High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy
– Magnus Brunner, European Commissioner for Internal Affairs and Migration
– Marco Tarquinio, Member of the European Parliament (MEP), Chair, EU–Albania Stabilisation and Association Parliamentary Committee
– Marta Kos, European Commissioner for Enlargement
– Michael McGrath, European Commissioner for Democracy, Justice and the Rule of Law
– Mounir Satouri (MEP), Chair, Subcommittee on Human Rights, European Parliament
– Roberta Metsola, President of the European Parliament
– Ursula von der Leyen, President of the European Commission

Embassies of EU Member States

– Embassy of Austria, Tirana, Ambassador Monika Zach
– Embassy of Belgium, Tirana, Ambassador Olga Cogen
– Embassy of Bulgaria, Tirana, Ambassador Ivaylo Kirov
– Embassy of Croatia, Tirana, Ambassador Zlatko Kramarić
– Embassy of Cyprus (accredited from Athens), Ambassador Stavros Avgoustides
– Embassy of the Czech Republic, Tirana, Ambassador Pavel Vacek
– Embassy of Denmark (accredited from Vienna)
– Embassy of Estonia (accredited from Athens), Ambassador Karin Rannu

– Embassy of Finland (accredited from Athens), Ambassador Leena Pylvänäinen
– Embassy of France, Tirana, Ambassador Catherine Suard
– Embassy of Germany, Tirana, Ambassador Karl Bergner
– Embassy of Greece, Tirana, Ambassador Lambrini Komini
– Embassy of Hungary, Tirana, Ambassador Martina Kasnyik
– Embassy of Ireland (accredited from Athens), Ambassador Ciara O'Floinn
– Embassy of Italy, Tirana, Ambassador Marco Alberti
– Embassy of Latvia (accredited from Rome), Ambassador Elita Gavele
– Embassy of Lithuania (accredited from Athens), Ambassador Andrius Kalinda
– Embassy of Luxembourg (accredited from Luxembourg), Ambassador Marc Hübsch
– Embassy of Malta (accredited from Valletta), Ambassador Anthony Licari
– Embassy of the Netherlands, Tirana, Ambassador Marleen Monster
– Embassy of Poland, Tirana, Chargé d'Affaires a.i. Wojciech Unolt
– Embassy of Portugal (accredited from Rome)
– Embassy of Romania, Tirana, Ambassador Octavian Șerban
– Embassy of Slovakia, Tirana, Ambassador Albín Otruba
– Embassy of Slovenia, Tirana, Ambassador Jakob Štunf
– Embassy of Spain, Tirana, Ambassador Gabriel Cremades Ventura
– Embassy of Sweden, Tirana, Ambassador Niklas Ström

Embassies of Key International Partners

– Embassy of Canada (accredited from Rome), Ambassador Elissa Ann Golberg
– Embassy of the Republic of Kosovo, Tirana, Ambassador Skënder Durmishi
– Embassy of Montenegro, Tirana, Chargé d'Affaires a.i. Vana Durašević
– Embassy of the Republic of North Macedonia, Tirana, Ambassador Vele Trpevski
– Embassy of Norway (accredited from Zagreb), Ambassador Arne Sannes Bjørnstad
– Embassy of Switzerland, Tirana, Ambassador Siri Walt
– Embassy of the Republic of Türkiye, Tirana, Ambassador Barış Ceyhun Erciyes

– Embassy of the United Kingdom, Tirana, Ambassador Nicholas Abbott

United Nations

– Ambassador Sidharto Reza Suryodipuro, President of the UN Human Rights Council
– António Guterres, Secretary-General of the United Nations
– Committee on Freedom of Association, International Labour Organization (ILO)
– Gina Romero, UN Special Rapporteur on the Rights to Freedom of Peaceful Assembly and of Association
– Ingrid Macdonald, UN Resident Coordinator in Albania
– IOM (International Organization for Migration) Albania
– Suela Janina, Permanent Representative, Permanent Mission of Albania to the United Nations, New York
– UN Committee against Torture
– UN Committee on Economic, Social and Cultural Rights
– UN Committee on the Rights of the Child
– UN Human Rights Committee
– UN Office on Drugs and Crime (UNODC)
– UN Special Rapporteur on Extreme Poverty and Human Rights
– UN Special Rapporteur on Freedom of Opinion and Expression
– UN Special Rapporteur on the Human Right to a Clean, Healthy and Sustainable Environment
– UN Special Rapporteur on the Independence of Judges and Lawyers
– UN Special Rapporteur on the Right to Adequate Housing
– UN Special Rapporteur on the Right to Education
– UN Special Rapporteur on the Right to Health
– UN Special Rapporteur on the Right to Privacy
– UN Special Rapporteur on the Situation of Human Rights Defenders
– UN Special Rapporteur on Torture
– UN Special Representative of the Secretary-General on Violence against Children
– UN Subcommittee on Prevention of Torture
– UN Voluntary Fund for Victims of Torture
– UN Women Albania
– UN Working Group on Arbitrary Detention

– UN Working Group on Business and Human Rights
– UN Youth Office
– UNDP Albania
– UNESCO, Freedom of Expression and Safety of Journalists
– UNFPA Albania
– UNICEF Albania
– Vasilika Hysi, Permanent Representative, Permanent Mission of Albania to the UN Office at Geneva
– Volker Türk, United Nations High Commissioner for Human Rights

International Institutions

– Alain Berset, Secretary General of the Council of Europe
– Ambassador Michel Tarran, Head of the OSCE Presence in Albania
– Council of Europe Children's Rights Division
– Council of Europe Platform for the Protection of Journalism and Safety of Journalists
– Director, OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights
– European Commission for Democracy through Law (Venice Commission)
– European Committee for the Prevention of Torture & Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT)
– Feridun Sinirlioğlu, Secretary General of the OSCE
– Giulia Re, Head of the Council of Europe Office in Tirana
– Group of States against Corruption (GRECO), Council of Europe
– Ignazio Cassis, OSCE Chairperson-in-Office (Swiss Chairpersonship 2026)
– International Institute for Democracy and Electoral Assistance (International IDEA)
– Jan Braathu, OSCE Representative on Freedom of the Media
– Mark Rutte, Secretary General of the North Atlantic Treaty Organization (NATO)
– Michael O'Flaherty, Council of Europe Commissioner for Human Rights
– Mykyta Poturaiev, President of the OSCE Parliamentary Assembly
– OECD Anti-Corruption Network for Eastern Europe and Central Asia
– President, Parliamentary Assembly of the Council of Europe

Human Rights and Democracy Organizations

– American Bar Association Center for Global Programs

– Amnesty International
– ARTICLE 19: Global Campaign for Free Expression
– Association of Independent Creators and Activists “Geto” (Bosnia and Herzegovina)
– Association of Journalists of Kosovo
– Association of Journalists of Macedonia
– Balkan Civil Society Development Network (BCSDN)
– Centre for Development of Non-Governmental Organisations (CRNVO), Montenegro
– Centre for European Volunteering (CEV)
– Centre for Law and Democracy
– Centre for Promotion of Civil Society (CPCD), Bosnia and Herzegovina
– Child Rights International Network (CRIN)
– CIVICUS: World Alliance for Citizen Participation
– Civil Rights Defenders
– Committee to Protect Journalists
– COSPE (Cooperation for the Development of Emerging Countries)
– Defence for Children International
– Democracy Reporting International
– Dignity Humanitarian NGO (Armenia)
– Don Bosko Centre (Montenegro)
– Education International
– European Center for Not-for-Profit Law
– European Centre for Press and Media Freedom (ECPMF)
– European Council on Refugees and Exiles (ECRE)
– European Federation of Journalists
– European Fund for the Balkans
– European Network of National Human Rights Institutions (ENNHRI)
– European Network of Ombudspersons for Children (ENOC)
– European Students’ Union (ESU)
– Fair Trials
– Free Press for Eastern Europe (FPEE)
– Free Press Unlimited
– Freedom House
– Friedrich Ebert Stiftung

– Front Line Defenders
– Heinrich Böll Stiftung
– Helsinki Foundation for Human Rights
– Human Rights First
– Human Rights House Foundation
– Human Rights Watch
– Index on Censorship
– International Bar Association's Human Rights Institute (IBAHRI)
– International Center for Not-for-Profit Law
– International Commission of Jurists
– International Crisis Group
– International Federation for Human Rights (FIDH)
– International Federation of Journalists
– International Partnership for Human Rights (IPHR)
– International Press Institute
– International Rehabilitation Council for Torture Victims (IRCT)
– International Republican Institute
– Konrad Adenauer Stiftung
– Kosovar Civil Society Foundation (KCSF)
– Kosovo Law Institute (KLI)
– Lawyers for Lawyers
– Legal Aid Society of Moldova
– Legal Centre (Pravni centar), Montenegro
– Local Democracy Agency Montenegro
– Macedonian Center for International Cooperation (MCIC)
– Media Freedom Rapid Response (MFRR)
– National Democratic Institute
– National Endowment for Democracy
– Netherlands Helsinki Committee
– NGO Active Zone (Montenegro)
– NGO Our Action (Naša akcija), Montenegro
– Norwegian Helsinki Committee
– Open Society Foundations
– Penal Reform International
– Physicians for Human Rights

– REDRESS
– Reporters Without Borders (RSF)
– Robert F. Kennedy Human Rights
– SafeJournalists Network
– Save the Children
– Scholars at Risk
– South East Europe Media Organisation (SEEMO)
– Terre des hommes
– Transparency International
– Transparency International Bosnia and Herzegovina
– Westminster Foundation for Democracy
– World Organisation Against Torture (OMCT)

Albania – Institutions

– Altin Dumani, Head, Special Structure against Corruption and Organized Crime (SPAK)
– Bajram Begaj, President of the Republic of Albania
– Besnik Dervishi, Commissioner for the Right to Information and Protection of Personal Data
– Consulate General of the Republic of Albania in New York
– Endrit Shabani, People's Advocate (Ombudsman) of Albania
– Ermonela Xhafa, Executive Director, National Diaspora Agency (Agjencia Kombëtare e Diasporës – AKD)
– Ervin Bushati, Ambassador, Embassy of the Republic of Albania in Washington, D.C.
– Ervin Demo, Minister of Internal Affairs
– Ferit Hoxha, Minister for Europe and Foreign Affairs
– Genta Tafa (Bungo), Commissioner for Protection from Discrimination
– Klevis Qose, General Director, Police Oversight Agency (Agjencia e Mbikëqyrjes së Policisë)
– Lazim Destani, Chairman, Diaspora Coordinating Council (Këshilli Koordinues i Diasporës – KKD)
– Maksim Haxhia, Chair, National Chamber of Advocacy (Dhoma Kombëtare e Avokatisë)
– Niko Peleshi, Speaker of the Parliament of Albania
– Olsian Çela, Prosecutor General of the Republic of Albania

– Skender Hita, General Director of the State Police
– Tirana District Prosecutor’s Office

Albania – Civil Society
– Active Durrës Centre (Qendra “Durrësi Aktiv”)
– Albanian Center for Economic Research (ACER)
– Albanian Helsinki Committee
– Albanian Human Rights Group
– Albanian Ornithological Society (AOS)
– Albanian Rehabilitation Centre for Trauma and Torture
– All Green Centre
– ALTRI Center (Qendra ALTRI)
– Association of Journalists of Albania (AGSH)
– CRCA/ECPAT Albania (Children’s Human Rights Centre of Albania)
– EcoAlbania
– ESD Albania
– European Movement in Albania
– Gender Alliance for Development Center (GADC)
– Institute for Democracy and Mediation
– Institute for Political Studies (ISP)
– Partners Albania for Change and Development
– Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri (Center for Gender Justice in Albania)
– Qëndresa Qytetare
– Res Publica Center (Qendra “Res Publica”)
– Rrjeti Erasmus Tirana
– Rrjeti “Barazi në Vendimmarrje” (Equality in Decision-Making Network)
– Science and Innovation for Development Center (SCiDEV)

Kontakt

Albanians Without Borders
Phone: 646-235-2211
Email: info@albanianswithoutborders.com
Website: albanianswithoutborders.com